



**PROGRAM ORIENTUES
PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”
2024**

**PËR
ARSIMIN FILLOR**



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE.....	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR.....	4
FUSHA: DOKUMENTACIONI KURRIKULAR.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK- ut NË MËSIMDHËNIE.....	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT.....	10
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE.....	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË CIKLIT FILLOR.....	11



HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” për arsimin fillor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve (mësuesve) që do t’i nënshtrohen testimit “Mësues për Shqipërinë”.

Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kërkesat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe performimin e përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit (mësuesit). Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët (mësuesit) që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumentacioni zyrtar¹i cili lidhet me profesionin dhe shërben si rregullator në punën e përditshme të mësuesit për çdo institucion arsimor.
- Dokumentacioni kurrikular i arsimit fillor nga klasa 1-5.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore e programeve lëndore, në klasat 1-5.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve (mësuesve) të arsimit fillor është hartuar për të mbështetur e për të nxitur zhvillimin e tyre profesional, si dhe për t'u ardhur në ndihmë për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve (mësuesve) për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e, në mënyrë të veçantë, të risive të reformës arsimore, pjesë e së cilës është edhe arsimit fillor;
- zhvillimin e kompetencave profesionale, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- zhvillimin e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësisve shkencore të kurrikulave lëndore, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- zbatimin me saktësi të rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe;
- vlerësimin e aftësive shkencore, pedagogjike, metodike dhe etike të kandidatëve (mësuesve) që do të testohen.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve (mësuesve) është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, krahas kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë një mësues i arsimit fillor.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm nga kandidati (mësuesi), programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet që priten të zotërojë një mësues në fushën e njohurive dhe të aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese në funksion të tyre.

FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme: <i>Mësuesi i arsimit fillor:</i> <ul style="list-style-type: none">- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar;- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;- demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.- Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.- Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar.- Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.

<p>mësimdhënies e të nxënit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	--

FUSHA: DOKUMENTACIONI KURRIKULAR

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i paketës së dokumenteve kurrikulare të arsimit fillor”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zotëron përmbajtjen e dokumentacionit kurrikular që zbaton në shkollë; - zbaton programet lëndore duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre; - përshtat programet lëndore në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programeve; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në programe; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programeve të reja; 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza Kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë nga klasa përgatitore deri në klasën e pestë 2014. - Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënit për arsimin fillor-Shkalla 1 dhe 2, IZHA 2016. - Programet e arsimit fillor nga klasa 1-5.

<ul style="list-style-type: none"> - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve nga njëra klasë në tjetrën); - shpjegon lidhjen ndërmjet dokumenteve kurrikulare; - për zgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave; - siguron informacion që demonstroi integrimin ndërlëndor. 	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE

Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike për mësimdhënien e lëndëve të arsimit fillor”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikoi punën afatshkurtër dhe 	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzuesi metodik i zbatimit të kurrikulës së arsimit fillor, ASCAP, 2021 - Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.

<p>afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj disiplinave shkencore; - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit; - orienton nxënësit për krijimin dhe mbushjen e portofolit të nxënësit, me detyra, punime, projekte dhe materiale të tjera që tregojnë interesin e tyre për të nxënë. 	
<p>Kompetenca II</p> <p>“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive për realizimin e mësimdhënies ndërvepruese”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për përmbushjen e rezultateve të kompetencave kyç; - përdor metoda e teknika që nxisin 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese me në qendër nxënësin. - Udhëzues dhe materiale mbështetëse orientuese për organizimin e orës së mësimi. - Situatat e të nxënësit, IZHA, 2015 - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.

<p>mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</p> <ul style="list-style-type: none"> - planifikon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me nxënësin në qendër; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik, krijues dhe ndërveprues të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një testi. 	
<p>Kompetenca III</p> <p>“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton materiale të lëndëve të ndryshme duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Word etj.; - nxiti nxënësit të bëjnë prezantime e punime të thjeshta duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga interneti për të pasuruar dhe përmirësuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. - Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. - Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.

<p>mësimdhënien;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare lëndore apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga interneti. 	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat, 30.11.2013. - Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Kompetenca	Literatura e rekomanduar

“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme: <i>Mësuesi i arsimit fillor:</i> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË CIKLIT FILLOR

Kompetenca “Zgjidhja dhe argumentimi shkencor i koncepteve lëndore që trajtohen në arsimin fillor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit fillor:</i> <ul style="list-style-type: none"> - dallon konceptet dhe shprehjet kryesore të çdo programi lëndor të ciklit fillor nga klasa 1-5; - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve shkencore në secilin program lëndor; - përshkruan përshkallëzimin vertikal dhe horizontal të koncepteve dhe shprehjeve lëndore; - zgjidh me saktësi dhe me mënyra të 	<p>Programe dhe tekste të nxënësve si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e çdo lënde të arsimit fillor, nga klasa I-V</p>

ndryshme ushtrime, kërkesa, situata problemore, eksperimente etj.	
--	--

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al